



Prof.asoc.dr.Abdurrahim Maxhuni

(Instituti Albanologjik, Prishtinë)

Bio e shkurtër

Abdurrahim Maxhuni, doktor në gjuhësi, bashkëpunëtor i lartë në Degën e Gjuhësisë, është shef i Degës së Gjuhësisë në Institutin Albanologjik. Është kryeredaktor i revistës shkencore “Gjuha shqipe”, organ i Institutit Albanologjik. Dr. Maxhuni ka qenë anëtar i redaksisë së revistës shkencore “Gjurmime albanologjike”-seria filologjik. Ka marrë pjesë në dhjetëra konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare si dhe ka botuar dhjetëra punime shkencore në revista të ndryshme shkencore. Dr. Maxhuni është hartues në Fjalorin e Madh të Gjuhës Shqipe, projekt i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Me Institutin Albanologjik ka botuar veprat:

1. *Vështrim mbi leksikun dhe frazeologjinë e Vushtrrisë me rrethinë*, monografi, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017, ISBN 978-9951-24-043-7.
2. *Terminologjia e kompjuteristikës në gjuhën shqipe*, monografi, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2020, ISBN 978-9951-24-108-3.
3. *Bibliografi e revistës “Gjuha shqipe” (1982-2022)*, bibliografi, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2022, ISBN 978-9951-24-156-4.
4. *Rreth leksikut terminologjik islam në gjuhën shqipe*, monografi, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2023, 978-9951-24-174-8.
5. *Fjalor dialektor i së folmes shqipe të Vushtrrisë*, fjalor, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2024, ISBN 978-9951-24-195-3.
6. *Studime gjuhësore*, përmbledhje punimesh, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2025, ISBN 978-9951-24-215-8.
7. *“Gjurmime albanologjike”, seria e shkencave filologjike (1962-2022)*, bibliografi, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2025, ISBN 978-9951-24-222-6.
8. *Fjalor i Madh i Gjuhës Shqipe*, fjalor, hartues, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

Titulli: Lëvizjet e gjuhëtarëve midis Tiranës e Prishtinës pas vitit 1970

Abstrakt

Pas Plenumit të Brioneve, ku nga pushteti u rrëzua Aleksandër Rankoviçi, albanologjia në ish-Jugosllavi filloi të shënonte hapa të rëndësishëm në zhvillimin e saj institucional. Në vitin 1967 u rithemelua Instituti Albanologjik, duke mundësuar që edhe çështjet gjuhësore të trajtoheshin në mënyrë institucionale. Kështu, në vitin 1968 u mbajt Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, e cila konsiderohet si pararendëse e Kongresit të Drejtshkrimit (Tiranë, 1972), si dhe u organizua sesioni shkencor kushtuar Kongresit të Manastirit (1969). Rrethanat e reja politike mundësuan themelimin e Universitetit të Prishtinës (1970), ndërsa në vitin 1975 u themelua Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Po kështu, një ngjarje me rëndësi kombëtare ishte Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, i mbajtur në Tiranë më 1972, i cili shënoi një hap të rëndësishëm në fushën e albanologjisë dhe përmbylli një kapitull të gjatë të standardizimit të shqipes. Një ngjarje tjetër me rëndësi në fushën e gjuhësisë është fillimi i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, i cili ka mbledhur studiues shqiptarë dhe të huaj. Të gjitha këto ngjarje patën ndikim të madh në zhvillimin e albanologjisë dhe të gjuhësisë në veçanti. Rivendosja e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe ish-Jugosllavisë gjatë viteve 1970–1972 ndikoi drejtpërdrejt në bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Këto ndryshime hapën një kapitull të ri bashkëpunimi edhe në mes të gjuhëtarëve të Shqipërisë dhe Kosovës, duke mundësuar shkëmbime akademike të profesorëve, mbajtjen e ligjëratave në Tiranë dhe Prishtinë, si dhe pjesëmarrjen në simpoziume, konferenca dhe tryeza shkencore. Me rëndësi të veçantë ishte pjesëmarrja e gjuhëtarëve nga Kosova në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë. Në këtë kumtesë do të vështrohet bashkëpunimi ndërmjet gjuhëtarëve të Shqipërisë dhe Kosovës pas vitit 1970.

Fjalët kyçe: *Lëvizje, gjuhëtarë, Shqipëri, Kosovë, aktivitete shkencore.*